



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJË
KRYETARI

Nr. 5744 Prot.

Ersekë, më 17.10.2025

VENDIM

Nr. 40, Datë 17.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK 2026-2028 DHE PLANIT VJETOR 2026
TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM”**

Bazuar në pikën “ç” të nenit 12 Ligjit Nr. 114, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” (ndryshuar me Ligjin Nr. 12, datë 02.02.2023 “Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”), “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, si dhe Shkresës Nr. 13111 Prot, datë 10.09.2025 “Mbi Përgatitjen e Planit Strategjik dhe Vjetor të Veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitet 2026-2028” të Ministrisë së Financave, pasi shqyrtoi Planin Strategjik 2026-2028 dhe Planin Vjetor 2026 të përgatitur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm,

VENDOS:

1. Miratimin e Planit Strategjik 2026-2028 dhe Planit Vjetor 2026.
2. Ngarkohet Njësia e Auditit të Brendshëm për marrjen e masave të nevojshme për vënien në zbatim të tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

PLANI STRATEGJIK PËR VEPRIMTARINË E NJËSISË SË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM BASHKIA KOLONJË, PËR PERIUdhËN 2026-2028

STRUKTURA E PLANIT STRATEGJIK

I.	Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NjAB	2
II.	Organizimi i NjAB dhe kuadri ligjor	4
III.	Objektivat strategjikë	5
IV.	Identifikimi i subjekteve	7
V.	Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare.....	8
VI.	Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve	10
VII.	Kufizimet e Auditimit	12
VIII.	Prioritet për tre vite	12

PASYQRA E TABELAVE

I.	Pasqyra Nr.1	14
II.	Pasqyra Nr.2.....	17

I. Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NjAB

I.I Qëllimi i Planit Strategjik

Plani Strategjik 2026-2028 “Për Veprimtarinë e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë” ka si qëllim identifikimin e fushave të veprimit të Strukturës së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kolonjë, për periudhën 3 (tre) vjeçare.

Ai bazohet në analizën e risqeve të programeve dhe veprimtarive të identifikuara për auditim dhe përcakton mbulimin/frekuencën e auditimit sipas subjekteve që programohen për auditim. Plani Strategjik 2026-2028 i veprimtarisë së angazhimeve të auditimit të brendshëm hartohet një herë në vit dhe ka marrë në konsideratë informacionet nga manaxhimi i lartë i GMS-së. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë parë me kujdes problematikat e trajtuara nga GMS-ja në mbledhjet e zhvilluara në vitin 2025.

Gjatë hartimit të Planit Strategjik 2026-2028 janë marrë parasysh angazhimet e pranuar dhe jemi bazuar në mundësinë e angazhimit për të përmirësuar manaxhimin e risqeve, shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimtarive të bashkisë. Gjatë hartimit të Planit Strategjik 2026-2028 janë marrë në konsideratë dhe auditimet e kryera nga KLSH në Bashkinë Kolonjë i cili ka mbuluar me auditim periudhën deri në fund të vitit 2024.

Plani Strategjik 2026-2028 “Për Veprimtarinë e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë”, është një element i kontrollit për t’u siguruar që të gjitha veprimtaritë, programet dhe operacionet e bashkisë dhe subjekteve në varësi të saj, mbulohen nga funksioni i Auditit të Brendshëm. Sektori i Auditimit të Brendshëm është konsultuar dhe ka rënë dakord me Titullarin e Institucionit, lidhur me problemet e kontroleve të brendshme të administrimit si dhe ka synuar që të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin e veprimtarive kryesore me risk më të lartë. Angazhimet e Auditimit të Brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave 3 (tre) vjeçare për auditime. Vlerësimi i nevojave të auditimit do të rishikohet çdo vit, në kohën kur do të hartohet Plani Vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar që janë përfshirë të gjitha veprimtaritë e reja dhe ndryshimet e tjera të programeve.

Gjatë hartimit të Planit Vjetor dhe Strategjik 2026-2028 janë mbajtur parasysh dhe ndryshimet strukturore dhe organizimet e reja në drejtori dhe sektorë të Bashkisë Kolonjë si dhe Rregullorja e Bashkisë. Në rast ndryshimi strukturor Plani Vjetor dhe Plani Strategjik do të rishikohen për t’iu përshtatur nevojave aktuale të njësisë.

Në hartimin e këtij plani rëndësi i është kushtuar dhe porosive të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Publik, Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm me shkresën Nr. 13111 Prot., datë 10.09.2025 protokolluar me tonën me Nr.5071 Prot., datë 18.09.2025 “Mbi përgatitjen e Planit Strategjik dhe Vjetor të veprimtarisë së Njësies së Auditimit të brendshëm për vitet 2026-2028”. Në këtë kuadër, në Planin Strategjik janë planifikuar disa lloj auditimesh:

1. Auditim Përputhshmërie;
2. Auditim Financiar;
3. Auditim Tematik;
4. Auditim të Kombinuar;
5. Auditim Performance etj.

I.II Misioni i NjAB

Auditimi i Brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektive, synon të ndihmojë subjektet e audituara të Bashkisë Kolonjë të përmbushin objektivat e tyre. Ai bën vlerësime, jep opinione dhe rekomandime objektive:

- Për identifikimin, vlerësimin dhe manaxhimin e riskut;
- Për funksionimin dhe mjaftueshmërinë e sistemeve;
- Për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontroleve;
- Për përputhjen e veprimtarisë së njësisë me kuadrin rregullator;
- Për funksionimin e elementëve të kontrollit të brendshëm (ambientin e kontrollit, manaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi-komunikimi dhe monitorimi);
- Për ruajtjen e aseteve;
- Për besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- Për të siguruar titullarin e subjektit të audituar se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet, efikasitet, sipas planifikimit dhe qëllimit të miratimit në buxhetin e bashkisë;
- Për përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve të njësisë;
- Për identifikimin dhe analizimin e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve për funksionimin e sistemeve;
- Për përshtatjen e strategjisë së auditimit me ndryshimet në objektivat strategjike dhe vetë strategjinë e organizatës, politikat dhe procedurat e saj si dhe menaxhimin e riskut dhe kontrollit.

Për parandalimin e shkeljeve ligjore dhe të fenomeneve jo të këndshme në keqmanaxhim nga drejtoritë dhe sektorët në varësi të Bashkisë Kolonjë, Auditimi i Brendshëm ndihmon manaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshilla në rastet kur kjo kërkohet dhe informacion lidhur me veprimtaritë që ka vlerësuar. Duke asistuar të gjitha nivelet e manaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, i jep manaxhimit të lartë vlerësime të operacioneve e veprimeve, këshillime të pavarura, besueshmëri për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi të burimeve.

II. Organizimi i NjAB dhe kuadri ligjor

II.I Organizimi i NjAB

Struktura e NjAB në Bashkinë Kolonjë është në nivel njësie (Sektori). Struktura është miratuar me 1 (një) përgjegjës dhe me 2 (dy) specialistë auditi. Momentalisht struktura funksionon vetëm me një përgjegjës dhe një specialist dhe pritet plotësimi i saj me një specialist tjetër të fushës së financës.

Njësia bazohet në legjislacionin si më poshtë vijon në kryerjen e veprimtarisë së saj:

1. Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” (*i ndryshuar*);
2. Ligjit Nr. Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
3. Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave;
4. Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;
5. Urdhërin Nr.4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016”;
6. Rregulloja e Bashkisë Kolonjë, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak për “Organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Kolonjë”, si dhe të gjitha rregulloret e njësisë, ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë;
7. Rregullore e Brendshme e Njesisë së Auditit të Brendshëm, miratuar me Aktin Nr. 2520 Prot., datë 23.05.2024;
8. Kodit të Etikës së Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Kolonjë, miratuar me Urdhërin Nr. 516, datë 26.09.2024 të Kryetarit të Bashkisë;
9. Kartës së Auditit të Brendshëm të Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Kolonjë, miratuar me Urdhërin Nr. 517, datë 26.09.2024 të Kryetarit të Bashkisë;
10. Standardet Ndërkombëtare Për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm;
11. Marrëveshja e Facilitetit e lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, ratifikuar me Ligjin Nr. 19/2025.

III. Objektivat strategjike

Vizioni i Njesisë së Auditit të Brendshëm është të jetë një strukturë e pavarur dhe profesionale që kontribuon në mirëqeverisjen e bashkisë, përmes sigurimit të një auditimi të brendshëm cilësor, të paanshëm dhe të bazuar në standarde ndërkombëtare, duke rritur përgjegjshmërinë, transparencën dhe përdorimin efikas të fondeve publike për të mirën e qytetarëve

Objektivat strategjike të NJAB-së janë të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të gjithë subjektet e audituar. Të detajuara objektivat janë:

1. Dhënia e sigurisë objektive, që risqet janë identifikuar dhe vlerësohen dhe menaxhohen nga strukturat përgjegjëse.
2. Dhënia e sigurisë së arsyeshme se sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet në shkallë të përshtatshme brenda subjekteve të audituara.
3. Dhënia e sigurisë së pavarur dhe objektive, dhënia e këshillimeve të cilat shtojnë vlerën, përmirësojnë operacionet dhe ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat.
4. Planifikimi dhe kryerja e auditimeve të kombinuara (Sistemi i Përputhshmërisë dhe Financiar).
5. Kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të manaxhimit.
6. Krijimin e një koncepti të ri për auditimin e brendshëm si funksion i pavarur, si mbështetje për manaxhimin për realizimin me sukses të detyrave të tij.

Për mbështetjen e objektivave strategjike të Njesisë së Auditit të Brendshëm në përputhje me qëllimet e organizatës, Njësia synon të ndërmarrë një sërë iniciativash dhe aktiviteteve konkrete që kanë si qëllim rritjen e efektivitetit dhe vlerës së shtuar të funksionit të auditimit. Këto përfshijnë zhvillimin e metodologjive për identifikimin dhe vlerësimin e riskut, forcimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ofrimin e këshillimeve objektive për përmirësimin e proceseve, si dhe kryerjen e auditimeve të kombinuara (financiare dhe të përputhshmërisë) bazuar në standarde ndërkombëtare. Po aq do të marrë masat që të ruajë ekuilibrin midis angazhimeve të auditimit dhe atyre këshilluese, aty ku do të vlerësohet e nevojshme. Gjithashtu, përfshihen auditime të kërkuara nga menaxhmenti dhe promovimi i auditimit të brendshëm si një funksion i pavarur që mbështet drejtimin efektiv të organizatës. Këto veprime ndihmojnë në forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe mirëqeverisjes në nivel lokal.

Në rast të ndryshimeve në objektivat strategjike apo në strategjinë, politikat dhe procedurat e organizatës, Njësia e Auditit të Brendshëm do të përshtasë strategjinë e saj në mënyrë fleksibile dhe dinamike, duke rishikuar Planin Vjetor e Strategjik të auditimit dhe prioritetet e saj në përputhje me drejtimit e reja organizative. Procesi i menaxhimit të riskut do të integrohet në mënyrë të vazhdueshme në planifikimin e auditimeve, për të siguruar që auditimet fokusohen në fushat me risk më të lartë dhe me ndikim më të madh në arritjen e

objektivave të organizatës. Njësia do të vlerësojë dhe përshtasë qasjen e saj ndaj kontrollit të brendshëm, duke rishikuar dhe përditësuar metodologjitë dhe mjetet e përdorura, me qëllim që të sigurojë vazhdimësinë e efektivitetit të funksionit të saj, pavarësisht ndryshimeve strukturore apo strategjike brenda organizatës. Vlen të theksohet se do të merren masat për koordinimin me ofruesit e jashtëm të sigurisë.

Përveç këtyre objektivave, Njësia do të fokusohet në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme etike dhe profesionale në të gjitha nivelet e auditimit. NjAB do të punojë për rritjen e ndërgjegjësimit të strukturave të audituara mbi rëndësinë e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut. Forcimi i komunikimit dhe shkëmbimi i informacionit me menaxhmentin dhe strukturat e tjera mbikëqyrëse do të jenë gjithashtu një prioritet kyç.

IV. Identifikimi i subjekteve

Për periudhën 2026-2028 janë planifikuar gjithësej 19 (nëntëmbëdhjetë) auditime sipas burimeve aktuale të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, nga të cilat 6 (gjashtë) subjekte në vitin 2026 dhe 7 (shtatë) subjekte në vitin 2027 dhe 6 (gjashtë) subjekte në vitin 2028.

Në planin e vitit 2026 janë planifikuar 6 misione auditimi, përkatësisht:

1. Subjektet e audituara 2025. (Zbatimi i detyrave);
2. Drejtoria Ekonomike, e Financës dhe Buxhetit. (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura; Fondet IPA etj.);
3. Drejtoria e të Ardhurave, Tatim-Taksave;
4. Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve;
5. Drejtoria e Turizmit dhe Agroturizmit;
6. Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit.

Në planin e vitit 2027 janë planifikuar 7 misione auditimi, përkatësisht:

1. Subjektet e audituara 2026. (Zbatimi i detyrave);
2. Drejtoria Ekonomike, e Financës dhe Buxhetit. (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura, fondet IPA etj.);
3. Drejtoria e të Ardhurave, Tatim-Taksave;
4. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
5. Drejtoria e Mbrojtjes Civile;
6. Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit;
7. Tre Njësitë Administrative.

Në planin e vitit 2028 janë planifikuar misione auditimi, përkatësisht:

1. Subjektet e audituara 2027 (Zbatimi i detyrave);
2. Drejtoria Ekonomike, Financës dhe Buxhetit (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura, fondet IPA etj.);
3. Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave;
4. Drejtoria e Arsimit;
5. Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike;
6. Sektori i MNZSH.

V. Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare

Sipas subjekteve, janë identifikuar fushat si vijon:

Bashkia sipas fushave:

1. Drejtoria e Shërbimeve Publike:
 - a. Sistemi i shërbimeve;
 - b. Eco Kolonja;
 - c. Sistemi i zhvillimit të komunitetit, punët publike;
 - d. Sistemi i dekorit dhe ndriçimit të rrugëve;
 - e. Sistemi i rrugëve rurale.
2. Drejtoria e Turizmit dhe Agroturizmit:
 - a. Sistemi i zhvillimit të turizmit;
 - b. Sistemi i infopoint dhe guidave;
 - c. Sistemi i muzeut dhe bibliotekës.
3. Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit:
 - a. Sistemi i kulturës dhe teatrit;
 - b. Sistemi i trashëgimisë dhe traditës;
 - c. Sistemi i qendrës kulturore;
 - d. Sistemi i sportit.
4. Drejtoria e Shërbimit Social dhe Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve:
 - a. Sistemi i ndihmës ekonomike;
 - b. Sistemi i strehimit;
 - c. Sistemi i Qendrës Sociale “Motrat Qirjazi”;
 - d. Sistemi i Kopshtit Nr. 1 “Afërdita Kole”;
 - e. Sistemi i Kopshtit Nr. 2 “Marie Gjergo”;
 - f. Sistemi i Kopshtit “Jani Vreto”, Leskovik;
 - g. Sistemi i edukatorëve të qendrave administrative;
 - h. Sistemi i Çerdhes “Motrat Qirjazi”;
 - i. Sistemi i sektorit mbështetës.
5. Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit:
 - a. Sistemi i menaxhimit pyjor;
 - b. Sistemi i inspektimit pyjor dhe trajtimit drusor;
 - c. Sistemi i shërbimit të furnizimit me dru zjarri.
6. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:
 - a. Sistemi i bujqësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit;
 - b. Sistemi i Bordit të Kullimit.
7. Drejtoria e Mbrojtjes Civile:
 - a. Sistemi i emergjencave civile;
 - b. Sistemi i Policisë Bashkiake.
8. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse:
 - a. Sistemi i burimeve njerëzore;
 - b. Sistemi i shërbimeve të brendshme;
 - c. Sistemi i shërbimeve digjitale dhe online;

- d. Sistemi i Gjendjes Civile.
- 9. Drejtoria e të Ardhurave, Tatim-Taksave:
 - a. Sistemi i vlerësimit dhe regjistrimit tatimor;
 - b. Sistemi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve të brendshme.
- 10. Drejtoria Ekonomike, Financës dhe Buxhetit:
 - a. Sistemi i Buxhetit;
 - b. Sistemi i financës dhe kontabilitetit.
- 11. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit:
 - a. Sistemi i projekteve, zhvillimit dhe lejeve;
 - b. Sistemi i integritetit evropian, këndi i BE.
- 12. Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike:
 - a. Sistemi juridik;
 - b. Sistemi i prokurimeve publike.
- 13. Drejtoria e Arsimit:
 - a. Sistemi i arsimit parauniversitar;
 - b. Sistemi i konviktit.
- 14. Sektori i MNZSH.

Njësitë Administrative:

- 1. Njësia Administrative Qendër-Ersekë- Auditimi i plotë i veprimtarisë së gjithë sistemeve të Njesisë Administrative.
- 2. Njësia Administrative Qendër-Leskovik- Auditimi i plotë i veprimtarisë së gjithë sistemeve të Njesisë Administrative.
- 3. Njësia Administrative Mollas-Çlirim- Auditimi i plotë i veprimtarisë së gjithë sistemeve të Njesisë Administrative.

VI. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Gjithsej janë 6 (gjashtë) subjekte për t'u audituar në vitin 2026, 7 (shtatë) në vitin 2027 dhe 6 (gjashtë) në vitin 2028. Në total subjekte për t'u audituar për periudhën 2026-2028 janë 19 (nëntëmbëdhjetë).

Në të tre vitet e planit strategjik janë parashikuar për t'u audituar me parë drejtoritë/sectorët dhe fushat me risk të lartë, duke mbajtur parasysh edhe ndryshimet strukturore e fushat e reja që i bashkohen veprimtarisë së bashkisë, në kuadrin e reformës territoriale, si dhe frekuenca e auditimit. Përmendim Drejtorinë Ekonomike, Financës dhe Buxhetit dhe Drejtorinë e të Ardhurave, Tatim-Taksave.

Në vlerësimin e riskut jemi nisur nga rezultatet e auditimeve të mëparshme për subjektet dhe fushat e parashikuara për auditim. Ndërsa për subjektet dhe fushat e reja, vlerësimi i riskut është bërë përgjithësisht në nivelin e lartë për shkak të njohjes së kufizuar të veprimtarisë së tyre.

Në hartimin e Planit Strategjik të NjAB kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

- **Rëndësia**- NjAB shpenzon më shumë kohë për fushat e reja dhe më me rëndësi për bashkinë.
- **Materialiteti**- Për fushat më të mëdha të të ardhurave dhe shpenzimeve të harxhohet më shumë kohë auditimi.
- **Ndryshimi**- Kur një sistem apo fushë ka ndryshuar, risku rritet, prandaj NjAB shikon për këto ndryshime në vitin që janë bërë ndryshimet.
- **Risku**- Burimet e NjAB t'i kushtohen fushave ku risku është më i lartë.
- **Pikëpamjet e Manaxhimit**- NjAB merr në konsideratë shqetësimet e manaxherëve.
- **Frekuenca**-Frekuencë më e shpeshtë te subjektet me risk më të lartë.
- **Ndikimi i Jashtëm**- Monitorimi i Strukturës së NjAB.

Analiza **SWOT** (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats) për Njësinë e Auditit të Brendshëm:

Pikat e Forta (Strengths):

1. Pavarësia organizative e auditit të brendshëm;
2. Njohuri e thelluar e proceseve të brendshme të organizatës;
3. Aftësia për të ofruar vlerë të shtuar dhe përmirësim të vazhdueshëm;
4. Përdorimi i standardeve ndërkombëtare (p.sh. IIA - Institute of Internal Auditors);
5. Qasje sistematike dhe metodologji të strukturuar për vlerësim të rrezikut.

Dobësitë (Weaknesses):

1. Burime të kufizuara njerëzore;

2. Mungesë e ekspertizës specifike në fusha të reja si IT;
3. Varësi nga të dhënat e ofruara nga menaxhmenti ;
4. Paafësi për të ndikuar në mënyrë efektive në vendimmarrje strategjike;
5. Komunikim i pamjaftueshëm me menaxhmentin për rekomandimet.

Mundësitë (Opportunities):

1. Zhvillimi i teknologjisë së re;
2. Mundësi për bashkëpunim ndër funksional me drejtori të tjera (risku, kontrolli, etj.);
3. Rritja e ndërgjegjësimit për risqet e brendshme dhe të jashtme;
4. Trajnime dhe certifikime profesionale (CIA, CISA, etj.).

Kërcënimet (Threats):

1. Ndryshime të shpeshta në rregullore dhe legjislacion;
2. Nënvlërësim i funksionit të auditit;
3. Mungesë e bashkëpunimit nga njësitë e tjera.

Analiza e kufizimit midis gjendjes aktuale dhe gjendjes së dëshiruar paraqitet si më poshtë vijon:

Aspekti	Gjendja aktuale	Gjendja e dëshiruar	Kufizimi/Pengesat
Burimet	Niveli i burimeve njerëzore/teknologjike është i kufizuar	Burime të mjaftueshme për auditime të specializuara	Buxhet i ulët, mungesë trajnimi
Pozicioni strategjik	Fokus në zbatimin e rregullave	Rol proaktiv për menaxhimin e riskut	Mungesë mbështetje nga subjektet e audituar
Ekspertiza	Mungesë njohurish në fusha moderne (IT, analizë të dhënash)	Auditues të certifikuar	Mungesë trajnimesh/ kosto e lartë
Përdorimi i Teknologjisë	Përdorim minimal i teknologjisë	Auditim i bazuar në të dhëna dhe analiza të avancuara	Mungesë infrastrukture dhe njohurish
Ndikimi në vendimmarrje	Raportim normal, ndikim i kufizuar	Roli këshillues në strategji dhe qeverisje	Komunikim joefektiv, mungesë respekti profesional

VII. Kufizimet e Auditimit

Pavarësisht rolit thelbësor që ka auditimi i brendshëm në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme, zbatimi i tij në praktikë përballlet me një sërë kufizimesh që ndikojnë në cilësinë dhe ndikimin e procesit të auditimit. Këto kufizime burojnë si nga faktorë të brendshëm të organizatës, ashtu edhe nga perceptime të gabuara mbi funksionin e auditimit nga subjektet e audituara. Mungesa e pavarësisë reale, burimet e kufizuara, bashkëpunimi i pamjaftueshëm dhe mosrespektimi i rekomandimeve janë vetëm disa prej sfidave që pengojnë realizimin e plotë të misionit të auditimit të brendshëm. Identifikimi dhe adresimi i këtyre kufizimeve është thelbësor për rritjen e efektivitetit të këtij funksioni dhe për arritjen e gjendjes së dëshiruar të qeverisjes institucionale. Disa nga kufizimet janë si më poshtë:

- Vlerësimi i auditimit si njësi inspektimi nga titullarët e subjekteve dhe fushave të parashikuara për auditim.
- Ndryshimet e planit të parashikuar për shkak të kërkesave të titullarit për projekte apo detyra të posaçme.
- Mungesa e bashkëpunimit reciprok dhe përgjegjshmëria e subjekteve që auditohen.
- Mungesa e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve nga vetë subjektet që auditohen.
- Mungesa e veprimtarive të kontrollit të brendshëm të vendosura nga vetë subjektet që auditohen.
- Mungesa e certifikimit të audituesve.
- Mungesa e reagimit në kohë nga subjektet e audituara mbi rekomandimet e lëna.

VIII. Prioritet për tre vite

Për të rritur efektivitetin, cilësinë dhe rolin strategjik të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB), është e domosdoshme përcaktimi i prioriteteve afatmesme që orientojnë zhvillimin dhe forcimin e këtij funksioni. Prioritetet për tre vitet e ardhshme synojnë jo vetëm përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe funksionale të audituesve, por edhe konsolidimin e një strukture të qëndrueshme që siguron cilësinë e procesit të auditimit, transparencën në raportim dhe pajtueshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi. Këto prioritete janë ndërtuar në funksion të rritjes së besueshmërisë dhe vlerës që NjAB i ofron strukturave drejtuese, duke e pozicionuar auditimin e brendshëm si një partner të rëndësishëm në përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të organizatës. Më specifikisht prioritetet parqiten si më poshtë:

- Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve.
- Monitorimi i strukturës së NjAB, sigurimi i cilësisë së auditimit.
- Monitorimi i sistemit të raportimit të të dhënave për veprimtarinë e NjAB-së.
- Zhvillimi i veprimtarisë së NjAB-së në pajtueshmëri me Kartën e AB-së dhe dispozitat ligjore.

- Ofrimi i sigurisë së tillë që veprimtaria e NjAB-së të konsiderohet nga strukturat e larta drejtuese si shtim vlere dhe përmirësim i aktivitetit të subjekteve.
- Përmirësimi i sistemit të ndjekjes dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit, me qëllim rritjen e ndikimit dhe vlerës së shtuar të procesit të auditimit në përmirësimin e proceseve organizative.
- Zgjerimi i fushëveprimit të auditimit në fusha me risk të lartë, përfshirë auditime tematike në teknologjinë e informacionit, menaxhimin e riskut, dhe fushat me ndikim të lartë buxhetor apo operacional.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e jashtme mbikëqyrëse dhe auditime të tjera (p.sh. auditimi i jashtëm, organet rregullatore etj.), për të siguruar harmonizim të aktiviteteve dhe shmangie të mbivendosjes së funksioneve të kontrollit.

Bashkëngjitur me Planin Strategjik gjenden anekset si më poshtë:

Ankeset e Planit Strategjik:

- Pasqyra Nr.1 “*Vlerësimi i nevelit të riskut për subjektet për vitet 2026-2028*”, sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave.
- Pasqyra Nr.2 “*Plani Strategjik i subjekteve të synuara për t’u audituar në vitet 2026-2028*”, sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave.

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Përgjegjës i Komanduar

Laura Skënderas



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA KOLONJË

Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për periudhën 2026-2028

Nr. Rendor	SUBJEKTE PËR T'U AUDITUAR	FUSHA PËR T'U AUDITUAR	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1.	2.	3.	4.	5.
	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Sistemi i shërbimeve Eco Kolonja		X	
		Sistemi i zhvillimit të komunitetit, punët publike		X	
		Sistemi i dekorit dhe ndriçimit të rrugëve			X
		Sistemi i rrugëve rurale		X	
2.	Drejtoria e Turizmit dhe Agroturizmit	Sistemi i zhvillimit të turizmit			X
		Sistemi i infopoint dhe guidave		X	
		Sistemi i muzeut dhe bibliotekës		X	
3.	Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit	Sistemi i kulturës dhe teatrit			X
		Sistemi i trashëgimisë dhe traditës		X	
		Sistemi i qëndrës kulturore		X	
		Sistemi i sportit	X		
4.	Drejtoria e Shërbimit Social dhe Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	Sistemi i ndihmës ekonomike		X	
		Sistemi i strehimit			X
		Sistemi i Qendrës Sociale “Motrat Qirjazi”		X	
		Sistemi i Kopshtit Nr. 1 “Aferdita Kole”			X
		Sistemi i Kopshtit Nr. 2 “Marie Gjergo”			X

12.	Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike	Sistemi juridik			
		Sistemi i prokurimeve publike		X	
13.	Drejtoria e Arsimit	Sistemi i arsimit parauniversitar			X
		Sistemi i konviktit			X
14.	Spektori i MNZSH	Auditim i plotë i gjithë veprimtarisë		X	
15.	Njësia Administrative Qendër-Ersekë	Auditim i plotë i gjithë veprimtarisë		X	
16.	Njësia Administrative Qendër-Leskovic	Auditim i plotë i gjithë veprimtarisë		X	
17.	Njësia Administrative Mollas-Çlirim	Auditim i plotë i gjithë veprimtarisë		X	

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
Përgjegjës i Komanduar
Laura Skënderas

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA KOLONJË

Plani Strategjik i subjekteve të synuara për t'u audituar për vitet 2026-2028

Nr	SUBJEKTE PËR T'U AUDITUAR SIPAS VITEVE					
	VITI I PLANIFIKUAR 2026	NIVELI I RISKUT	VITI I PLANIFIKUAR +1 2027	NIVELI I RISKUT	VITI I PLANIFIKUAR +2 2028	NIVELI I RISKUT
a.	1	2	3	4	4	6
1.	Subjektet e audituara 2025. (Zbatimi i detyrave)	I mesëm				
2.	Drejtoria Ekonomike, e Financës dhe Buxhetit. (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura, Fondet IPA etj.)	I lartë				
3.	Drejtoria e të Ardhurave, Tatim-Taksave	I lartë				
4.	Drejtoria e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	I mesëm				


5.	Drejtoria e Shërbimit Social	I mesëm					
6.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	I mesëm					
7.	Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit	I mesëm					
8.			Subjektet e audituara 2026. (Zbatimi i detyrave)	I mesëm			
9.			Drejtoria Ekonomike, e Financës dhe Buxhetit. (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura, fondet IPA etj.)	I lartë			
10.			Drejtoria e të Ardhurave, Tatim-Taksave	I lartë			
11.			Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	I mesëm			
12.			Drejtoria e Mbrojtjes Civile	I mesëm			
13.			Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit	I mesëm			
14.			Njësia Administrative Qendër-Ersekë	I mesëm			

15.			Njësia Administrative Qendër-Leskovik	I mesëm		
16.			Njësia Administrative Mollas-Çlirim	I mesëm		
17.					Subjektet e audituara 2027 (Zbatimi i detyrave)	I mesëm
18.					Drejtoria Ekonomike, e Financës dhe Buxhetit. (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura, fondet IPA etj.)	I lartë
19.					Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave	I lartë
20.					Drejtoria e Arsimit	I mesëm
19.					Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike	I lartë
21.					Sektori i MNZSH	I mesëm

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSSHËM

Përgjegjës i Komanduar

Laura Skënderas





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

**PLANI VJETOR PËR VEPRIMTARINË E NJËSISË SË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM BASHKIA KOLONJË, PËR VITIN 2026**

STRUKTURA E PLANIT VJETOR

I.	Zhvillimet aktuale të NJAB	2
II.	Prioritetet e auditimit për vitin 2026.....	2
III.	Objektivi (at) kryesore për vitin 2026.....	3
IV.	Programimi i llojit të angazhimeve	5
V.	Planifikimi i kostos për vitin 2026	5
VI.	Planifikimi i burimeve për vitin 2026	7
VII.	Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim	7
VIII.	Sigurimi i brendshëm i cilësisë	8

TABELA E PASYQRAVE

I.	Pasqyra Nr.3	9
II.	Pasqyra Nr.4	12
III.	Pasqyra Nr.5	13

I. Zhvillimet aktuale të NJAB

Aktualisht, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë ka përmirësuar dhe zgjeruar aktivitetet e saj për të rritur transparencën dhe efikasitetin e menaxhimit të burimeve publike. Kjo njësi është përgjegjëse për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe për sigurimin e këshillave të pavarura për drejtimin e bashkisë. Përmes një procesi të rregullt auditimi, është bërë monitorimi dhe vlerësimi i menaxhimit të riskut, proceseve të kontrollit dhe qeverisjes së përgjithshme të njësisë publike.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë funksionon sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar nga legjislacioni përkatës, si dhe i raporton Kryetarit të Bashkisë për çdo parregullsi që mund të përbëjë shkelje administrative apo penale. Gjithashtu, janë marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të audituesve të brendshëm për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e auditimeve që kryejnë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë për vitin 2026 ka planifikuar 6 (gjashtë) auditime prej të cilave pritet të realizohen 6 (gjashtë).

II. Prioritetet e auditimit për vitin 2026

Për vitin 2026, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë ka përcaktuar një sërë prioritetesh që synojnë përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike dhe rritjen e transparencës në administratën publike. Për të përcaktuar prioritetet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2026, janë marrë parasysh disa faktorë kyç që ndikojnë në suksesin dhe efikasitetin e këtij funksioni. Prioritetet janë bazuar në analizën e risqeve, ndryshimet në ambientin rregullator, objektivat strategjike të organizatës dhe nevojat e palëve të interesuara. Këto prioritete përfshijnë:

1. Rritjen e Transparencës dhe Llogaridhënies:

- a) Zbatimi i praktikave të mira për raportimin e qartë dhe të saktë të rezultateve të auditimit.
- b) Forcimi i komunikimit me qytetarët dhe palët e interesuara përmes publikimeve të rregullta të raporteve të auditimit.

2. Përmirësimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm:

- a) Vlerësimi i efektivitetit të sistemeve ekzistuese të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimi i përmirësimeve të nevojshme.
- b) Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave të reja për menaxhimin e riskut.

3. Auditimin e Projekteve dhe Investimeve Publike:

- a) Monitorimi i përdorimit të fondeve publike në projekte infrastrukturore dhe investime të tjera të rëndësishme.
- b) Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe efektivitetit të këtyre projekteve.

4. Trajnimin dhe Zhvillimin Profesional i Stafit të Auditimit:

- a) Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për audituesit e brendshëm për t'i mbajtur ata të përditësuar me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.
- b) Zhvillimi i programeve të certifikimit dhe specializimit për stafin e auditimit.

5. Përmirësimin e Procesit të Menaxhimit të Riskut:

- a) Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të mundshme në operacionet e bashkisë.
- b) Hartimi i strategjive për menaxhimin efektiv të këtyre risqeve për të minimizuar ndikimet negative.

6. Fokusimin në Auditimet e Performancës:

- a) Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të shërbimeve publike të ofruara nga bashkia.
- b) Propozimi i rekomandimeve për përmirësimin e performancës dhe optimizimin e burimeve.

7. Planifikimin e auditimeve me objekte të posaçme si:

- a) Vlerësimin e sistemit të detyrimeve të prapambetura.
- b) Vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve, i planifikuar për periudhën Janar-Mars të vitit pasardhës.
- c) Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në strukturat që menaxhojnë fondet IPA dhe fonde të tjera të BE-së.
- d) Auditimin e masave për zbatimin e Marrëveshjes së Facilitetit.

Këto prioritete janë hartuar në përputhje me objektivat strategjike të bashkisë dhe me qëllim për të siguruar një administratë publike më të përgjegjshme, transparente dhe efektive. Për zbatimin e tyre, Njësia e Auditimit të Brendshëm do të bashkëpunojë ngushtë me drejtori të ndryshme brenda bashkisë dhe me institucione të tjera përkatëse.

III. Objektivi(at) kryesore për vitin 2026

Auditi i Brendshëm, në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektive synon të ndihmojë subjektet e audituara të Bashkisë Kolonjë, të përmbushin objektivat e tyre. Ai bën vlerësime, jep opinione dhe rekomandime objektive:

1. Për funksionimin dhe mjaftueshmërinë e sistemeve;
2. Për përputhjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore;

3. Për funksionimin e elementëve të kontrollit të brendshëm (ambientin e kontrollit, menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi-komunikimi dhe monitorimit);
4. Për të siguruar titullarin e subjektit të audituar se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet, efikasitet, sipas planifikimit dhe qëllimit të miratimit në buxhetin e bashkisë.

NjAB ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshilla dhe informacion lidhur me veprimtaritë që ka vlerësuar. Duke asistuar të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, i jep menaxhimit të lartë vlerësime të operacioneve e veprimeve, këshillime të pavarura dhe konfidenciale.

Qëllimi i funksionit të auditimit të brendshëm, përveç sa parashikohet nga nenet 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” (*i ndryshuar*), është të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të gjitha subjektet e audituara. Në mënyrë të detajuar NjAB ka si objektiva kryesore për vitin 2026:

1. Dhënien e sigurisë objektive, që sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet në shkallë të përshtatshme brenda subjekteve të planifikuara për auditimin gjatë vitit;
2. Dhënien e sigurisë së pavarur dhe objektive, dhënien e këshillimeve të cilat shtojnë vlerën, përmirësojnë operacionet dhe ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat;
3. Planifikimin/kryerjen e auditimeve, financiare, të kombinuara, tematike apo këshillues;
4. Kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të menaxhimit;
5. Krijimin e një koncepti të ri për auditimin e brendshëm si funksion i pavarur, si mbështetje për menaxhimin për realizimin me sukses të detyrave të tij;
6. Rishikimin dhe përmirësimin e sistemit të kontrolleve të brendshme për të siguruar që janë efektive dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.
7. Identifikimin dhe zbutjen e risqeve kryesore që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të organizatës;
8. Vlerësimin e efikasitetit të proceseve të brendshme dhe rekomandimin e përmirësimeve për të rritur produktivitetin dhe zvogëluar kostot.
9. Identifikimin e mundësive për optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e performancës operacionale;
10. Kontrollimi i përputhshmërisë me politikat, procedurat dhe rregulloret e brendshme, si dhe me ligjet dhe rregulloret përkatëse.
11. Ndihma në zhvillimin dhe përditësimin e politikave dhe procedurave për të siguruar përputhshmëri të vazhdueshme;
12. Edukimi dhe trajnimi i stafit për të rritur ndërgjegjësimin për menaxhimin e risqeve dhe rëndësinë e kontrolleve të brendshme.
13. Mbështetja e menaxhimit në identifikimin dhe menaxhimin efektiv të risqeve;
14. Përgatitja e raporteve të rregullta të auditimit për menaxhimin, duke përfshirë gjetjet dhe rekomandimet.

15. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit dhe vlerësimi i efektivitetit të përmirësimeve të zbatuara.

IV. Programimi i llojit të angazhimeve

Për vitin 2026 janë parashikuar 6 (gjashtë) auditime prej të cilave 5 (pesë) auditime janë parashikuar për fusha të subjektit të bashkisë dhe 1 (një) është auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga angazhim-auditimet e vitit paraardhës. Nga këto 6 (gjashtë) auditime, janë parashikuar:

1. Subjektet e audituara 2025. (Zbatimi i detyrave);
2. Drejtoria Ekonomike, e Financës dhe Buxhetit. (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura; Fondet IPA etj.);
3. Drejtoria e të Ardhurave, Tatim-Taksave;
4. Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve;
5. Drejtoria e Turizmit dhe Agroturizmit;
6. Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit.

V. Planifikimi i kostos për vitin 2026

Pjesë e rëndësishme e Planit Vjetor është planifikimi i kostove të auditimit dhe mbulimi i tyre. Ky proces na ka ndihmuar për të siguruar mbulimin me auditim të përshtatshëm të fushave me risk të lartë në subjektet që auditohen. Duke parashikuar kostot dhe alokimin e burimeve, shkëmbimi i informacionit dhe koordinimit të planeve të auditimit me KLSH-në, ndihmon për mbulimin më të mirë dhe mënjanon mundësinë e dublimit apo të mbivendosjes së punës. Në përcaktimin e kostove të auditimit, më konkretisht, në planifikimin e kohës së punës, krahas kohës së nevojshme për punën audituese janë marrë parasysh edhe faktorët:

- a) **Koha për mbikqyrjen**- e gjithë puna audituese është subjekt rishikimi nga përgjegjësi për të siguruar cilësinë e punës.
- b) **Koha për trajnim**- është planifikuar një kohë e caktuar për trajnim për rritjen profesionale të audituesve të brendshëm.
- c) **Koha për ndjekjen e rekomandimeve**- është koha për të verifikuar nëse menaxhimi ka vepruar në kohë për zbatimin e rekomandimeve.
- d) **Koha rezervë**- parashikohet për çështje të papritura që mund të dalin gjatë vitit.
- e) **Koha për menaxhim dhe administrim**- e cila parashikon kryerjen e detyrave të veçanta të caktuara nga menaxhimi dhe punë administrative.

Llogaritja e buxhetit të auditimit është kryer në mënyrë të përafërt duke marrë parasysh të dhënat mbi numrin e audituesve sipas strukturës që janë të punësuar aktualisht, si dhe treguesit aktualë mbi pagat dhe shtesat, sigurimet shoqërore, shpenzimet për udhëtime e dieta, internet, energji elektrike dhe kancelari.

Në planifikimin e kostos për vitin 2026 për Njësinë e Auditimit të Brendshëm u morën në konsideratë disa elementë të cilët ndihmojnë për të siguruar që njësi të ketë burimet e nevojshme për të funksionuar efektivisht dhe për të përmbushur detyrimet e saj. Disa nga elementët që janë marrë në konsideratë, vijnë si më poshtë:

1. Analiza e Nevojave

- **Vlerësimi i Programeve dhe Projekteve:** Janë identifikuar programet dhe projektet kryesore që Njësia e Auditimit të Brendshëm do të duhet të mbulojë në vitin 2026.
- **Identifikimi i Burimeve të Nevojshme:** Janë përcaktuar sa auditues dhe çfarë lloj aftësish janë të nevojshme për të përmbushur kërkesat.

2. Përlllogaritja e Kostove të Personelit

- **Paga dhe Përfitimet:** Janë llogaritur pagat dhe përfitimet për personelin aktual dhe është bërë planifikimi për rekrutime të reja nëse do të jetë e nevojshme.
- **Trajnime dhe Zhvillim Profesional:** Janë përcaktuar kostot për trajnime të rregullta dhe certifikime profesionale.

3. Kosto Operacionale

- **Teknologji dhe Pajisje:** Janë planifikuar kostot për mirëmbajtjen e softuerëve dhe harduerëve të nevojshëm për auditim.
- **Zyra dhe Infrastrukturë:** Janë përlllogaritur kostot e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera infrastrukturore.

4. Kosto të Jashtme

- **Konsulencë dhe Shërbime të Jashtme:** Është vlerësuar nëse ka nevojë për angazhimin e konsulentëve të jashtëm.
- **Auditime të Pavarura:** Janë përlllogaritur kostot për auditime të pavarura të kërkuara nga rregullatorët.

5. Rezervat për ngjarjet e paparashikuara

- **Kostot Emergjente:** Është parashikuar një rezervë për të mbuluar kostot emergjente ose të paparashikuara që mund të shfaqen gjatë vitit.

6. Monitorimi dhe Rishikimi

- **Rishikimi Periodik:** Janë përcaktuar intervale të rregullta për të rishikuar dhe përditësuar buxhetin në bazë të ndryshimeve të situatës ose nevojave të reja.

Nr.	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NjAB	Plani (lekë)	
1.	Buxheti gjithsej	2,733,560	Lek
2.	Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,383,560	Lek
3.	Shpenzime udhëtimi & dieta	200,000	Lek
4.	Të tjera (kancelari)	150,000	Lek
5.	Numri i punonjësve	2 Punonjës	
6.	Kosto për person (I/5)	1,366,780	Lek/Person

Tabela Nr. 1.

VI. Planifikimi i burimeve për vitin 2026

Llogaritja e burimeve të auditimit në ditë njerëz është kryer duke u bazuar në ditë pune të vlefshme në vit pa pushimet vjetore dhe festat zyrtare, si dhe auditues që janë të miratuar në strukturën e stafit të Sektorit të Auditimit për vitin 2026. Nga koha efektive e punës në ditë/njerëz, janë zbritur ditë njerëz që nevojiten për pushimet vjetore, festat zyrtare, pushimet javore, pushime për arsye shëndetësore, trajnime dhe angazhime të tjera si takime, mbledhje etj. Më konkretisht të dhënat janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NjAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e Burimeve
1.	Koha maksimale e vlefshme	260	520 (52 javë x 5 ditë x 3 persona)
2.	Pushime vjetore	22	44 ditë (22 ditë për person)
3.	Ditë pushimi (Festa zyrtare)	14	28 ditë (14 ditë për person)
4.	Pushime për arsye shëndetësore	5	10 ditë (5 ditë për person)
5.	Angazhime në trajnime	20	40 ditë (20 ditë për person)
6.	Angazhime në mbledhje/takime	6	12 ditë (6 ditë për person)
7.	Rezerva të planifikuara (të papritura)	5	10 ditë (5 ditë për person)
	TOTALI	188	376 ditë/person

Tabela Nr.2

VII. Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Për rritjen profesionale të strukturës së auditimit është planifikuar një kohë prej 10 ditë për secilin auditues, kjo sipas identifikimit të nevojave për trajnim të secilit auditues si dhe duke marrë parasysh mundësinë e tyre në ndjekjen e trajnimeve. Gjithashtu ky planifikim është bazuar dhe në trajnimin e detyrueshëm ligjor që kanë audituesit e certifikuar.

Nr.	Tematika e identifikuar për trajnim	Pjesëmarrës në trajnim (nr. personave)	Periudha (gjatë vitit)	Kohëzgjatja e trajnimit (në ditë)
1.	Trajnime fillestar profesional	2	Gjatë vitit	10 ditë
2.	Vlerësimi i riskut, menaxhimi i tij brenda organizatës dhe auditimi i bazuar në risk.	2	Gjatë vitit	4 ditë
3.	Teknikat e komunikimit, aftësitë interpersonale të audituesve dhe intervistimi.	2	Gjatë vitit	4 ditë
4.	Sigurimi i cilësisë së punës së NjAB-së.	2	Gjatë vitit	2 ditë

Tabela 3.

VIII. Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Sigurimi i cilësisë, bazuar në Standardin 1300, është konsideruar si kërkesë e domosdoshme për të identifikuar objektivist mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat efektive që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e punës audituese dhe njëkohësisht t'i shërbejë Bashkisë Kolonjë për t'u njohur me transparencën e përdorimit dhe administrimit të të ardhurave dhe shpenzimeve. Sigurimi i cilësisë për materialet e auditimit do të realizohet në proces të vazhdueshëm monitorimi dhe rishikim gjatë çdo angazhimi auditimi nga përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, konform kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm” të Manualit të Auditimit të Brendshëm.


Bashkëngjitur me Planin Vjetor gjenden anekset si më poshtë:

- Pasqyra Nr. 3 “Plani i angazhimeve të NjAB-së për vitin 2026” sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave.
- Pasqyra Nr. 4 “Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NjAB-së për vitin 2026”.
- Pasqyra Nr. 5 “Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NjAB-së për vitin 2026” sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave.

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Përgjegjës i Komanduar

Laura Skënderas



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA KOLONJË

PASQYRA NR.3

Plani i angazhimeve të NjAB-së për vitin 2026

Nr.	SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TËU AUDITUAR	FUSHA PËR TËU AUDITUAR	AUDITIME GJITHËSEJ	SHËRBIMET E SIGURISË					Shërbimet e këshillimit	Grupi i Auditimit (nr i audituesve)
				A.Të përputhshmërisë	A.Të performancës	A. financiare	A. tek-komunikimi	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
1.	Subjektet e audituara 2025. (Zbatimi i detyrave)	Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandive të NjAB	1	1						2
2.	Drejtoria Ekonomike, e Financës dhe Buxhetit. (Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura, Fondet IPA etj.)	Sistemi i Buxhetit Sistemi i financës dhe kontabilitetit Ekzekutimi i detyrimeve të prapambetura dhe Fondet IPA.	1					1		2
3.	Drejtoria e të Ardhurave, Tatim-Taksave	Sistemi i vlerësimit dhe regjistrimit tatimor Sistemi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve të brendshme	1					1		2
4.	Drejtoria e Shërbimit Social,	Sistemi i ndihmës ekonomike Sistemi i strehimit	1					1		2

6.	Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit	Sistemi i kulturës dhe teatrit	1					1		2
		Sistemi i trashëgimisë dhe traditës								
		Sistemi i qendrës kulturore								
		Sistemi i sportit								

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Përgjegjës i Komanduar
Laura Skënderas

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA KOLONJË


PASQYRA NR.4

Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NjAB-së për vitin 2026

Nr.	Tematika e identifikuar për trajnim	Pjesëmarrës në trajnim (nr. personave)	Periudha (gjatë vitit)	Kohëzgjatja e trajnimit (në ditë)
1.	Trajnimi fillestar profesional	2	Gjatë vitit	10 ditë
2.	Vlerësimi i riskut, manaxhimi i tij brenda organizatës dhe auditimi i bazuar në risk.	2	Gjatë vitit	4 ditë
3.	Teknikat e komunikimit, aftësitë interpersonale të audituesve dhe intervistimi.	2	Gjatë vitit	4 ditë
4.	Sigurimi i cilësisë së punës së NjAB-së.	2	Gjatë vitit	2 ditë
SHUMA				20

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Përgjegjës i Komanduar
Laura Skënderas



12

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM BASHKIA KOLONJË

PASQYRA NR.5

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NjAB-së për vitin 2026
000/ lekë

BURIMET E PLANIFIKUARA				BUXHETI I PLANIFIKUAR		
Nr.	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NjAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e Burimeve	Nr.	Buxheti gjithësej	Plani (lekë)
1.	Koha maksimale e vlefshme	260	520 (52 javë x 5 ditë x 2 persona)	1.	Buxheti gjithësej	2,733,560 Lek
2.	Pushime vjetore	22	44 ditë (22 ditë për person)	2.	Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,383,560 Lek
3.	Ditë pushimi (Festa zyrtare)	14	28 ditë (14 ditë për person)	3.	Shpenzime udhëtimi & dieta	200,000 Lek
4.	Pushime për arsye shëndetsore	5	10 ditë (5 ditë për person)	4.	Të tjera (kancelari)	150,000 Lek
5.	Angazhime në trajnime	20	40 ditë (20 ditë për person)	5.	Numri i punonjësve	2 Punonjës
6.	Angazhime në mbledhje/takime	6	12 ditë (6 ditë për person)	6.	Kosto për person (1/5)	1,366,780 Lek/Person
7.	Rezerva të planifikuara (të papritura)	5	10 ditë (5 ditë për person)			
	TOTALI	188	376 ditë/person			

PËR NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Përgjegjës i Komanduar
Laura Skënderas

